



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5835 Prot.

Lezhë, më 31 . 03 . 2021

VENDIM

Nr. 55 Datë 30 . 03 . 2021

Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2021

Në zbatim të nenit 54, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 96,500 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2021, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.604 për shumën 96,500 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.06260, Kap.01, Art.602 për shumën 96,500 lekë, fond i cili do të përdoret për financimin e shërbimit të varrimit të të ndjerëve L L dhe O M

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

